



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1799/23 Datë: 07/12/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (*përditësuar me vendimin Ref.932/22*), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 118-të, të mbajtur më datë 21.11.2023, mori:

V E N D I M

Për plotësim/ndryshim të vendimit Ref.1499/23D

- I. Aprovohet kërkesa e Kolegjit AAB Nr.prot.1491/23 e datës 27.10.2023 për ndryshimin e periudhës së akreditimit për programin e studimit; *Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS.*
- II. Ndryshohet periudha e akreditimit e përcaktuar në paragrafin I të vendimit Ref.1499/23D datë 27.10.2023, ku nga (1 tetor 2023 - 30 shtator 2026), bëhet **1 tetor 2024 deri 30 shtator 2027.**
- III. Pjesa tjetër e vendimit **Ref.1499/23D** datë 27.10.2023 mbetet në fuqi dhe e pandryshuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji AAB kampusi kryesorë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ndryshimin e afatit përkatësisht periudhës së akreditimit të programit duke kërkuar që periudha tre vjeçare e akreditimit të filloj nga **1 tetor 2024.**

Kolegji AAB kishte arsyetuar kërkesën si: Pasi që KShC kishte nxjerrë vendimin Ref.1499/23D datë 27.10.2023, dhe në këtë kohë është mbyllur sistemi SMIAL, nuk ka mundur të regjistrojë të dhënat për studentët në këtë sistem dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi të rekrutoj studentë të rinj për vitin akademik 2023/2024, kërkojmë nga KShC që të ndryshoj periudhën e akreditimit nga (1 tetor 2023 - 30 shtator 2026), në **1 tetor 2024 - 30 shtator 2027.**

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 118-të, të mbajtur më datë 21.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit AAB Nr.prot.1491/23 të datës 27.10.2023, dhe duke u bazuar në faktet e arsyetuara në kërkesë dhe kompetencat ligjore vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrij ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB kampusi kryesorë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë